

Dr. Shenoll Korkut

PROBLEMET E TË RINJVE DHE VETËVRASJA

Nga turqishtja:
Mr. Rehan Neziri

Kreuzlingen, 2021

Botim privat i përkthyesit
Redaktura gjuhësore: Zira Agushi
Kopertina: Xhelil Bajrami
Shtypi: Mjekësia – Tetovë
Tirazhi: 500 copë

Përmbajtja:

Në vend të parathënies	5
I. Rinia dhe problemet e të rinjve.....	9
II. Përgjithësisht për vetëvrasjen.....	19
III. Problemet e të rinjve dhe vetëvrasja	27
1. Përplasja midis brezave si një problem i të rinjve	27
2. Dukuritë psikologjike si një problem i të rinjve	29
3. Psikologjia e ankthit si një problem i të rinjve	34
4. Mekanizmat e komunikimit si një problem i të rinjve	39
5. Rrymat pesimiste, varësitë dhe të rinjtë	43
6. Bixhozi si një problem i të rinjve....	46
7. Prostitucioni dhe të rinjtë.....	49
8. Rinia dhe dashuria e pashpresë.....	50
IV. Problemet e të rinjve dhe parimet islame në lidhje me vetëvrasjen	53
1. Problemet e të rinjve dhe besimi në Zot	53
2. Problemet e të rinjve dhe besimi në Ahiret	60
3. Problemet e të rinjve dhe <i>teubeja</i> ..	63
4. Problemet e të rinjve dhe <i>tevekuli</i> .	66
5. Problemet e të rinjve dhe durimi ...	70
Përfundim	73

Në vend të parathënies

Rinia pjesa më e rëndësishme e jetës së njeriut

Librin që e keni në dorë, të nderuar lexues, me titull "*Problemet e të rinjve dhe vetëvrasja*", është i shkruar nga një teolog dhe profesor i filozofisë islame, si dhe njohës shumë i mirë i kësaj problematike, dr. Shenoll Korkut. Kurse bartja e kësaj vepre, edhe gjuhësisht edhe kuptimisht, nga gjuha turke në gjuhën shqipe, është bërë nga teologu dhe sociologu, gjegjësisht nga mjeshtri i kësaj pune, mr. Rehan Neziri.

Njeriu, në përgjithësi, ashtu siç Allllahu Fuqiptotë e ka bërë, ka një jetë përplot me sfida, telashe, të mira, të këqija, përgjegjësi, obligime, urdhëresat e ndalesa. Të gjitha këto, jo të ngjeshura në një periudhë të caktuar të jetës, por të shtrira në tërë jetën e tij. Periudha e cila ia mundëson njeriut

që të jetë i gatshëm ose më i përgatitur për t'u ballafaquar me këto sfida, është periudha e rinisë, gjegjësisht duke filluar nga rinia e hershme, konkretisht adoleshenca, madje edhe më herët se ajo. Mbushja e tij, në këtë periudhë të jetës, me njohuritë e nevojshme, me ndjenjën e nevojshme të përgjegjësisë, që ai të jetë sa më i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka ndaj Zotit, vetes, rrethit, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi, ia mundëson atij që të jetë më i përgatitur, të luajë rolin e njeriut më të përgatitur, më të denjë, që rregullisht do ta ketë prioritet vetëm atë që është e mirë, e bukur, e dobishme, atë me të cilën All-llahu i Madhërishëm do të jetë i kënaqur, me një fjalë, shumë më lehtë do ta ketë ta luftojë atë që është e dëmshme dhe e padobishme, gjegjësisht të mos e mendojë asnjëherë vrasjen e dikujt, kurse në asnjë mënyrë vetëvrasjen.

Autori, dr. Shenoll Korkut, të nderuar lexues, në këtë vepër të tij, duke i ana-

lizuar problemet me të cilat ballafaqohet rinia, si dhe duke i dedektuar bukur mirë ato, konkretisht për vetëvrasjen, gjenë edhe zgjidhjet e mundshme, si nga prizmi psikologjik, po ashtu edhe nga ai fetar islam, në lidhje me mënyrën e shpëtimit të njeriut nga këto probleme, konkretisht nga vetëvrasja, edhe atë me anë të *teubes* - pendimit të All-llahu xh.sh., *tevekkulit* - mbështetjes në All-llahun xh.sh. dhe *sabrit* - durimit në emër të All-llahut xh.sh..

Përkthyesi, mr. Rehan Neziri, me eloquencën dhe me mjeshturinë e tij, me përkthimin në shqip të kësaj vepre, lexuesit shqiptar i ka dhënë edhe një mundësi që të njihet më për së afërmi me qartësinë edhe të një fenomeni apo dukurie negative sociale, sikur që është vetëvrasja, me shkaqet e parqitjes së saj, si dhe me mënyrën e shpëtimit nga kjo dukuri. Kështu që, ai ka mundur që biblioteka jonë të

jetë e pasuruar edhe me një vepër si
kjo.

Çdo njërit, e sidomos atyre të moshës
së re, iu uroj lexim të këndshëm!

27 qershor 2021

Pof. Dr. Qani Nesimi
Myfti i Tetovës

Hyrje

I. Rinia dhe problemet e të rinjve

Rinia është njëra prej periudhave më të ndjeshme të jetës së njeriut në këtë botë. Fillimisht kjo është shenjë se njeriu ka arritur një distancë të konsiderueshme në perceptimin e botës. Me pjekjen e mendjes si dhe me zhvillimin e mënyrës së të menduarit tanimë i riu dalëngadalë arrin ta kuptojë edhe funksionimin e gjithësisë. Tanimë është pjekur aftësia e të kuptuarit të njeriut, pra të vetvetes, të botës, të shoqërisë, të kafshëve, të bimëve dhe të krijesave të tjera.

Në periudhën e rinisë njeriu arrin t'i vërejë e t'i kuptojë vetitë e trupit dhe të shpirtit që i janë dhënë amanet nga All-llahu xh. sh., ndërsa me periudhën e pubertetit ai edhe ngarkohet me përgjegjësi. Prandaj, ngarkimi me përgjegjësi njeriut i hap një fushë të lirisë në formimin e individualitetit të tij në çështjet materiale dhe shpirtë-

rore. Pas kësaj faze i riu dhe e reja do të mbahen përgjegjës për urdhëresat dhe ndalesat e fesë sonë, do t'i kryejnë ibadetet (ritualet fetare), do të mund vetë të marrin vendime në punët e mira ose të këqija.



Në të gjitha fazat e jetës së njeriut ka aspekte pozitive dhe negative që lidhen me fazën në fjalë. Arsyeja pse e mira është e bukur dhe e denjë për shpërblim, është ngase njeriu nuk e

zgjedh të keqen edhe pse ka mundësi ta bëjë atë. Njeriu në këtë botë nga ana e All-llahut Mëshirëplotë lihet kokë më kokë me alternativa të ndryshme. Ta zgjedhësh të mirën, kur ke shumë alternativa të tjera, është pikërisht ajo që të mirën e bën të kuptimtë. Të mirën që e bën, duke pasur mundësi ta zgjedhësh të keqen, është e mira e vërtetë. Për këtë arsye, dy burimet bazë të fesë sonë – Kur’ani dhe Sunneti - e lavdërojnë në mënyrë të veçantë rininë dhe periudhën e rinisë si dhe na lajmërojnë se ibadetet, të mirat, lutjet që kryhen në kohën e rinisë, se virtytet morale që i ka i riu dhe e reja, janë më të vlefshme sesa të njëjtat në fazat e tjera të jetës.

Për shkak të veçorive të rinisë që i përmendëm, bëhet e lehtë edhe ngjitja e disa sëmundjeve, varësive, shprehive dhe dukurive negative. I riu dhe e reja sot i shohin pranë dhe rreth vetes shumë shprehje të këqija si alkooli, droga, bixhozi dhe punë të tjera të kë-

qija të ndaluara nga ana e fesë sonë. Përveç kësaj, në qoftë se njeriu infektohet me këto vese qysh në periudhën e rinisë, ekziston mundësia që ato t'i vazhdojë tërë jetën.

Struktura tradicionale e shoqërisë, institucioni i familjes si dhe sistemi i ndërtuar që më parë herë-herë krijojnë fërkime e kundërshtime me energjinë e të rinjve dhe të rejave. Si rrjedhojë e kësaj shpeshherë e përjetojmë edhe paraqitjen e përplasjes midis brezave, mbetjen jashtë shoqërisë si dhe kryengritjen ndaj sistemit të vendosur tanimë.

Në një situatë të këtillë, disa rryma, doktrina e mendime pesimiste si dhe lëvizje sataniste, të cilat e shikojnë me dyshim dhe në mënyrë kritike funksionimin e natyrshëm të botës si dhe mësimet e fesë, e vënë nën shënjestër botën mendore dhe intelektuale të rinisë. Këto rryma në përgjithësi botën e bëjnë të pabanueshme për të rinjtë dhe të rejat si dhe i fusin ata

në një tension, trazirë dhe krizë të pakuptimtë. Njëri skaj i kësaj krize herë pas here na shfaqet në formën e vetëvrasjeve. Në qoftë se i marrim parasysh këto dukuri të vetëvrasjes, mund të kuptojmë se kjo fazë e rinisë është më kritikja në jetën e tyre, se disa prej këtyre të rinjve dhe të rejave janë të lidhur për jetën si me një fije pambuku edhe pse na duken shumë energjikë.

Disa specialistë periudhën e adoleshencës dhe të rinisë i trajtojnë si dy nivele të ndryshme dhe prandaj edhe problemet e tyre i analizojnë në bazë të këtij dallimi. Edhe pse bëhen dallime të këtilla në procesin e kalimit nga fëmijëria në rini, feja jonë periudhën e pubertetit e merr si një prag të kalimit nga fëmijëria në rini.



Në periudhën e adoleshencës, të cilën mund ta pranojmë si fazën e hershme të rinisë, bien në sy disa ndryshime fizike e mendore dhe i riu ose e reja këto paraqitje i sheh si elemente të huaja. Njeriu i moshës adoleshente para së gjithash nis të parashtrojë pyetje lidhur me imazhin e babait dhe të nënës që i kishte në fëmijëri. Me këtë sositje ai dëshiron të hapë fusha të reja të mundësive dhe të përgjegjësive në jetë. Po ashtu, në këtë periudhë njeriu tregon prirje për të mësuar sjelljen

sipas vlerave të shoqërisë. Njeriu i moshës adoleshente, në rrugëtimin e tij drejt të qenit i rritur, nis të fitojë disa veçori fizike, trupore, ndërsa këto ndryshime tek ai krijojnë një tension mendor, shpirtëror. Po kështu, njeriu i kësaj moshe është në fazën e përzgjedhjes së arsimimit ose profesionit të tij të ardhshëm. Për shkak të këtyre veçorive që i përmendëm, i riu ose e reja domosdo futet në një periudhë me tensione e probleme, por edhe me anë të bukura të saj.

I riu ose e reja priret që disa ndjenja, që janë të veçanta për njeriun, t'i jetojë në mënyrën më të qetë dhe më të skajshme të mundshme. Përderisa disa herë ai është shumë i lumtur, disa herë të tjera ai është shumë i pikëlluar dhe i pashpresë. Të njëjtën gjendje mund të themi se ai e përjeton edhe në raport me njerëzit e tjerë përreth, me shoqërinë, me shkollën dhe me familjen. Edhe pse familja ndonjëherë për të është një vend shu-

më qetësues, i dashur dhe i sigurt, ndonjëherë ajo mund t'i duket edhe si shumë i neveritshëm dhe si një institucion që nuk e ofron ndjenjën e përkatësisë. Si rrjedhojë e përjetimit të këtyre gjendjeve, për të riun dhe për të renë bëhet i vështirë krijimi i një baraspeshe midis botës së brendshme dhe të jashtme të tij/saj.

Të gjitha këto aventura në fakt tregojnë se i riu dhe e reja janë në kërkim të personalitetit të tyre. I riu dhe e reja nisin t'i kundrojnë dhe sodisin strukturat dhe institucionet shoqërore përreth vetes. Duke e soditur familjen mund të ndodhë përplasia midis brezave, gjeneratave; duke e soditur shoqërinë mund të shfaqen sjellje anti-sociale; duke e soditur fenë, mendimin politik si dhe mendësinë aktuale mund të ndodhë që i riu apo e reja të lidhen me struktura krejt të kundërta me këto që i përmendëm. Që i riu të mos bjerë në këtë situatë, nevojitet që ai t'i njohë mirë karaktere-

ristikat dhe veçoritë e moshës në të cilën ndodhet. Mirëpo, se i riu ndodhet në një fazë ku ai kërkon, sodit dhe kundërshton, kjo nuk do të thotë se ai del kundër gjithçkaje të arsyeshme. Hyrja në aktivitete të këtilla e një të riu në fakt lidhet me dëshirën dhe kërkesën e tij që nga këto fusha të krijojë një metodë dhe mendim të përshtatshëm si dhe rekomandime të arsyeshme për vetveten. Për aq sa do t'i arrijnë të rinjtë këto, aq do të kenë mundësinë që jetën e tyre ta kalojnë brenda kësaj kornize të arsyeshme e të logjikshme.

Të rinjtë dhe të rejat gjatë kësaj periudhe të tyre në fakt dëshirojnë ta dëshmojnë vetveten, të tregojnë se kush janë, se edhe ata janë bërë individë të rritur. Dëshira e tyre për pavarësi ndonjëherë mund të bëhet shkaktare për daljen nga kontrolli. Kjo gjendje te prindërit e tyre krijon shqetësim dhe merak, e ndonjëherë mund edhe t'i tendosë raportet e ty-

re. Atë që ne e quajmë përplasja të brezave a gjeneratave, zanafillën e ka pikërisht këtu. Në qoftë se përplasja e brezave merr një shtrirje të përgjithshme, atëherë do të nxjerrë krye edhe shqetësimi dhe meraku i shoqërisë për brezat e ardhshëm. Nuk duhet lejuar që të rinjtë të bien në prehrin e kësaj gjendjeje patologjike, përkundrazi duhet zhvilluar metoda e synime të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve të tyre. Në qoftë se këto prirje të riu si individ kanë arritur shkallën e skajshmërisë, atëherë duhet kërkuar ndihmën e profesionistëve. Se përplasja midis brezave herë pas here mund të çojë deri te vetëvrasja dhe madje edhe deri te rastet e dhunshme brenda anëtarëve të familjes, është një e vërtetë që vërehet te të gjitha shoqëritë.

II. Përgjithësisht për vetëvrasjen

Vetëvrasja, marrë në përgjithësi, nënkupton dhënien fund të jetës personale në mënyrë të vetëdijshme dhe me vetëdëshirë, duke përdorur çfarëdo një veprim të caktuar. Që një vdekje të mund të quhet vetëvrasje, duhet që individi i cili e kryen atë të jetë me mend, pra jo i çmendur. Sipas kësaj, vdekjet që ndodhin me pahir dhe pa paramendim nga vetë individi ose nga rrethi, nuk mund të quhen vetëvrasje.

Kur njeriu brenda një periudhe të caktuar mendon për vetëvrasje, këtë e quajmë *mendim për vetëvrasje*; kur njeriu për të arritur diçka shprehet se do të bëjë vetëvrasje, këtë e quajmë *kërcënim për vetëvrasje*; kur njeriu e lë derën hapur për t'u shpëtuar nga të tjerët dhe me këtë rast nuk ka për synim vdekjen por vetëm shtirjen për vetëvrasje, këtë e quajmë *tentim për vetëvrasje të shtirur*. Në disa situata

kur nuk mendohet vetëvrasja por bëhen tentime për vetëvrasje të shtirur, në fund të analizave të gjendjes mendore të të vdekurit kemi konstatimin për vetëvrasje. Shkencëtarët që kanë bërë hulumtime për vetëvrasjen dhe për njerëzit që kryejnë vetëvrasje, kanë konstatuar se dukuria e vetëvrasjes ka shumë shkaktarë filozofikë, biologjikë, sociologjikë, psikologjikë si dhe nga ata që lindin nga sëmundje të ndryshme.

Pa marrë parasysh se për çfarë arsyes kryhet vetëvrasja, feja islame vetëvrasjen e quan mëkat të madh dhe e ndalon rreptësisht. Në Kur'an thuhet:

"...dhe mos e mbytni veten tuaj! Vërtet, All-llahu është i mëshirshëm për ju."
(en-Nisa', 4:29)

Në Kur'an po ashtu theksohet se vrasja e një personi me pa të drejtë është e barabartë me vrasjen e mbarë njerëzimit (el-Maideh, 5:32).

Njëri prej shokëve të Muhammedit a.s., Amër bin Asi r.a., në betejën e quajtur Dhatu's-Selasil ishte bërë *xhunub* në ëndërr (për t'u pastruar). Meqë ishte shumë ftohtë dhe i frikëhej vdekjes ai mori *tejemmum*, edhe pse aty pranë kishte ujë. Me *tejemmum* ai ua fali të pranishmëve namazin si imam. Më pas ata e njoftuan për këtë edhe Muhammedin a.s., i cili kur dëgjoi për këtë i tha: "Ua prirë në namaz në këtë gjendje?". Ai i thotë se për këtë ishte mbështetur në ajetin e mësipërm (4:29).



Muhammedi a.s. atëherë kishte buzëqeshur dhe e kishte miratuar veprimin e tij (Ebu Davudi, Tahara 124; Ahmed b. Hanbel, IV, 203). Po kështu, në mesin

e shtatë mëkateve të mëdha shkatërrimtare që i përmend Muhammedi a.s. është edhe vrasja (përfshirë edhe vetëvrasjen), (Buhariu, Vesaja 23, Tibb 45; Muslimi, Iman 144). Gjatë betejës së Hajberit, një person me emrin Kuzman tregoi trimëri të madhe dhe me këtë rast edhe u plagos rëndë. Duke mos i duruar dhimbjet ai bën vetëvrasje me shpatën e vet. Për këtë person Muhammedi a.s. tha se do të jetë banor i Xhehennemit (Buhariu, Kader 5, Rikak 33, Megazi 38, Xhihad 77; Muslimi, Iman 179).

Edhe pse Islami në teori e ka ndaluar rreptësisht vetëvrasjen, në praktikë gjen shumë rrallë muslimanë që bëjnë vetëvrasje. (Shiko Franz Rosenthal, On Suicide in Islam, Journal of the American Oriental Society, 1946, (66) 3:239-259).

Dukuria e vetëvrasjes është mëkati (gjynahu) i vetëm për të cilin nuk është i mundur pendimi (*teubeja*). Edhe mundësia për pendim vlen për të gjitha mëkatet e tjera, qofshin të vogla apo të mëdha, për vetëvrasjen

nuk mund të thuhet se ka pendim, pasi aty tanimë është realizuar vdekja dhe njeriu i vdekur nuk mund të pendohet tanimë. Mirëpo pendimi (*teubeja*) është e mundur për tentim vetëvrasjeje.

Edhe pse Islami e ka ndaluar vetëvrasjen, ai nuk i lë vetëm ata që janë duke menduar për të ose që janë në një gjendje të rëndë shpirtërore e cila mund t'i çojë ata në vetëvrasje, porse u ofron atyre rrugëdalje nga kjo krizë me anë të imanit (besimit), ibadeteve, marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe mësimëve përcjellëse. Në qoftë se njeriu e përvetëson dhe e rivlerëson mësimin islam lidhur me besimin, me parimet bazë dhe me drejtësinë, ai ka mundësi të heqë dorë nga vetëvrasja, pa marrë parasysh se nga cilat arsye ai e ka menduar këtë.

Islami ia mbyll rrugën mëkatit të vetëvrasjes jo vetëm nëpërmjet aktiviteteve dhe lidhjeve sociale që i ka përcaktuar, por edhe nëpërmjet më-

simeve bazë, sistemit të besimit si dhe të nevojës për përforcimin e lidhjeve shoqërore midis muslimanëve. Sepse besimi se jeta e njeriut është e vlefshme dhe se vetëm Zoti është Ai që ka të drejtë t'ia përfundojë jetën atij, në njëfarë mase luan edhe funksionin mbrojtës kundër vetëvrasjes.

Janë zhvilluar teori të shumta dhe janë kryer hulumtime po ashtu të shumta në lidhje me relacionin midis besimit fetar dhe vetëvrasjes. Disa prej këtyre hulumtuesve kanë mbrojtur mendimin se besimi fetar nuk ka ndonjë ndikim në dukuritë e vetëvrasjes, disa të tjerë se besimi fetar e motivon vetëvrasjen, e disa të tjerë se besimi fetar e pengon vetëvrasjen. Mirëpo në të gjitha studimet empirike dhe sipas të gjitha statistikave është arritur në konstatimin e përbashkët se besimi fetar e pengon, e parandalon vetëvrasjen. Sipas kësaj, feja nuk e kufizon njeriun vetëm me jetën e kësaj bote, porse me dimen-

sionin e ahiretit (botës tjetër) ajo e vlerëson njeriun dhe jetën e tij. (Kemal Sayar, İntihar ve İnanç Sistemleri).

Feja në botën mendore të njeriut ndërton një spiritualitet dhe një botë të caktuar të vlerave. Kjo fushë metafizike, për vështirësitë që përjetohen në tokë, luan rolin e një fushe të ngushtëllimit, të bindjes dhe të shpresës. Po ashtu, te njerëzit që i takojnë të njëjtës fe, forcohen lidhjet e caktuara sociale dhe kjo ia zë rrugën vetëvrasjes që vjen si pasojë e vetmisë. Kjo veçanti e fesë më së shumti ka ndikim mbi njerëzit që jetojnë nëpër qytete.

Nëse e kundrojmë historinë islame do të shohim se dukuria e vetëvrasjeve në shoqërinë islame është një gjë shumë e rrallë. Shkaktare për këtë mund lirisht të themi se është feja islame me mësimet e saj teologjike të thjeshta, të kuptueshme, të arsyeshme dhe të përshtatshme me karakterin natyror të njeriut. Shumë

studiues perëndimorë e pranojnë faktin se pikërisht këto mësimet e parime të Islamit janë ato që e kanë penguar përhapjen e rasteve të vetëvrasjes në shoqëritë muslimane krahasuar me rastet në shoqëritë e tjera.

Dijetarët muslimanë e kanë mbrojtur mendimin se vetëm All-llahu xh.sh. e di nëse muslimani që kryen vetëvrasje ka shkuar me iman ose jo, prandaj edhe kanë thënë se atij do t'i lahet kufoma, do t'i falet namazi i xhenazes dhe do të varroset në varrezat muslimane.

Në mesin e rinisë së sotme, krahas problemit të papunësisë, edhe përplasjet midis brezave (gjeneratave), dashuritë e dështuara, besimi se në të ardhmen nuk mund të arrihet një status sipas idealit si dhe brenga se s'vlen për asgjë, janë shkaktarët kryesorë të rasteve të vetëvrasjes.

III. Problemet e të rinjve dhe vetë- vrasja

1. Përplasja midis brezave si një problem i të rinjve

Rinia, me fjalë të tjera, në thelb nënkupton mundësinë e shikimit të botës në një mënyrë të ndryshme dhe të re. Ngarkimi me përgjegjësi e personit që nga mosha e pubertetit sipas fesë sonë, e shënon pikërisht këtë. Një njeri i ri që e përjeton pubertetin ai tanimë është përgjegjës kundrejt Zotit, shoqërisë dhe vetvetes. Këtë gjendje mund ta kuptojmë edhe si një formë të fitimit të lirisë. Familja ka disa përgjegjësi kundrejt fëmijëve të saj. Para së gjithash një familje duhet ta sigurojë jetesën e fëmijëve të saj, duhet të sigurojë edukimin dhe arsimimin e tyre si dhe t'i mbrojë ata nga të këqijat e shoqërisë.

Fëmijët duhet rritur me dashuri e dhembshuri. Kjo nga arsyeja se frytet e para kundër dhunës dhe padrejtësi-

ve që u bëhen fëmijëve në moshë të hershme nisin të shfaqen në fazën e rinisë. Për këtë arsye, në kokën e fëmijës që rritet në një familje ku mbi-sundon dhuna, ajo familje për të do ta humbasë karakterin e një vendi të sigurt dhe shpirti i këtij njeriu të ri qetësinë që s'e ka gjetur në familje do ta kërkojë në vende dhe në shprehi të tjera.



Dashuria ndaj Zotit, kryerja e rregullt e adhurimeve, grumbulli i sjelljeve

morale që mbillen në shpirtrat e të rinjve që nga mosha e hershme e rinisë së tyre, do t'i bëjë këta të rinj që ta kalojnë këtë periudhë të jetës së tyre ashtu siç e ka lavdëruar Muhammedi a.s. Një i ri, i veshur me petkun e moralit të mirë, problemet e rinisë do t'i kalojë në mënyrë më të mençur, më të qetë, dhe nuk do të bjerë në kthetrat e mendimeve pesimiste dhe lëvizjeve të devijuara nga njerëzorja. Për më tepër, kjo do t'i mbrojë ata që të mos infektohen nga varësitë e ndryshme, të cilat mund ta çojnë atë deri edhe te vetëvrasja.

2. Dukuritë psikologjike si një problem i të rinjve

Secili rast i vetëvrasjes nuk është domosdo rrjedhojë e një çrregullimi psikologjik apo sëmundjeje psikiatrike. Njeriu edhe duke qenë i shëndoshë mendërisht e shpirtërisht, thjesht vetëm për shkak të një shqe-

tësimi të tepruar mund të tentojë të bëjë vetëvrasje. Në krye të shqetësimeve, në të cilat më së shumt bien të rinjtë, vjen depresioni. Depresioni nënkupton gjendjen kur njeriu e ndien veten të dëshpëruar, të mërzhitur, të pavlerë e të rraskapitur dhe e cila manifestohet edhe në aspektin fizik të tij me këputje, pagjumësi etj.

I riu i rënë në depresion mund të shfaqë edhe këto simptoma: mungesë rehatie, tension, nervozë, mosrespektim të rregullave, ndjenjë të sëmundjeve të kokës e të barkut, mungesë vetëbesimi, qarje, mbyllje në dhomë i vetmuar, dobësim i suksesit në shkollë, prishje e lidhjeve me shokët e shoqet etj.

Treguesi i depresionit dallon te fëmija, tek i riu dhe tek i rrituri. Si te sëmundjet trupore (somatike) ashtu edhe tek ato shpirtërore, me rëndësi është diagnostifikimi i hershëm. Për këtë arsye, në vend që ta shtypin, ta shpërfillin e ta hedhin brenda në

shpirt depresionin, shumë me rëndësi është që këta të rinj e të reja të kërkojnë ndihmën dhe mbështetjen profesionale. Duke nisur nga prindërit e tyre, të gjithë të rriturit e tjerë me të cilët këta të rinj të rënë në depresion kanë çfarëdo një lidhje, duhet të jenë të kujdesshëm dhe t'u ndihmojnë atyre në tejkalimin e këtij procesi. Po kështu, këtyre të rinjve nuk duhet hipur shumë mbi kokë kur janë në pyetje disa detyra e obligime të tyre, por natyrisht nuk duhet të lihen edhe tërësisht jashtë kontrollit; duhet të ruhet vija e hollë e baraspeshës midis këtyre dy situatave. Psikologët theksojnë se depresioni është një sëmundje që në vete bart rrezikshmëri të lartë për vetëvrasje.



Një prej problemeve që haset te adoleshentët është edhe paraqitja e vesveseve në jetën e përditshme. Këtu si vesvese mund të numërojmë edhe këto çrregullime: harxhimin e një kohe të gjatë në kryerjen e detyrave të shtëpisë pa ndonjë sukses të madh, fshirjen dhe rishkrimin e përsëritshëm të një teksti, kapjen dhe përhumbljen pas sendeve të imëta e të parëndësishme, harxhimi i tepruar i mjeteve higjienike gjatë pastrimit, skuqja të duarve nga larja e tepruar

me ujë, mostolerimi i të tjerëve të hyjnë në dhomën e tij ose t'i prekin sendet e tij etj. Në momentin e parë që të vihen re këto çrregullime duhet kërkuar trajtimin profesional, duhet penguar përparimin e tyre si dhe duhet përjashtuar nga jeta e të riut para se t'i hapet një shteg ndër të tjera edhe vetëvrasjes.

Në periudhën e rinisë zgjidhje presin problemet si adaptimi në sistemin shoqëror, përzgjedhja e profesionit, mundësia e punësimit etj. Në këtë stad i riu dhe e reja detyrohet ta jetojë gjendjen kundërthënëse midis asaj se çfarë është ai ose ajo vetë dhe çfarë pret shoqëria prej tyre. Një i ri dhe një e re që e jeton këtë kundërthënie nuk është e thënë që për çdoherë t'i refuzojë pritshmëritë e shoqërisë, shpesh ndodh që ata ta refuzojnë egon e vet, vetveten, pra bile edhe të bëjnë vetëvrasje.

3. Psikologjia e ankthit si një problem i të rinjve

Në mesin e problemeve të të rinjve duhet përmendur edhe ato që kanë të bëjnë me të qenët nxënës. Në vendin



tonë mospjeksi në mësim shihet si një element i rëndësishëm në vetë-vrasjet që lidhen me problemet e të rinjve. Kjo situatë shkakton rrënjosen dhe daljen jashtë kontrollit të elementit të ankthit në botën e brendshme të të rinjve. Ankthi ose frika për të ardhmen e kaplon të riun ose të renë nga çdo anë dhe qoftë një situatë që

lind nga bota e brendshme e të riut ose të resë qoftë një presion që vjen nga familja, nga miqtë ose nga rrethi, të gjitha këto e nxisin dhe e intensifikojnë akoma më shumë këtë ankth në botën e brendshme të tyre. Elementet që më së shumti e nxisin ankthin që të kalojë në një shqetësim psikologjik e më pastaj edhe në një proces të brendshëm shpirtëror që mbërrin deri në vetëvrasje, janë provimet që i përjetojnë të rinjtë.

Në veçanti provimet e shkollave të mesme dhe ato të universiteteve bëhen shkak që të rinjtë e të rejat këtë periudhë të rinisë së tyre ta kalojnë me ankth, frikë, shqetësim dhe emocione të dendura. Është vënë re se disa të rinj kanë menduar të bëjnë vetëvrasje për shkak të mospjekësive në provimet pranuese për në universitet, se në botën e tyre të brendshme kanë bërë plane për vetëvrasje dhe se në fund edhe kanë tentuar përnjëmend të vetëvriten. Po kështu, disa të

rinj e të reja edhe pse kanë kaluar momente shumë të lumtura në vitet e shkollës së mesme, frika për të ardhmen, provimet për punësim, struktura kozmopolite e qyteteve të mëdha si dhe problemet e veta të veçanta që i kanë vitet e studimeve në universitet, këta të rinj e të reja i çojnë që jetën e tyre studentore ta kalojnë me dhimbje e derte të mëdha. Paralelisht me këtë edhe kalimi në karrierë pas studimeve universitare paraqet njërin nga problemet më të mëdha të të rinjve të vendit tonë.

Në rrënjosjen shpirtërore të frikës, të gajles e të ndjenjës së mossuksesit lidhur me provimet dhe me të ardhmen, rol të rëndësishëm luajnë po ashtu edhe familja, rrethi familjar si dhe grupet e shokëve e shoqeve. Për t'i mbrojtur të rinjtë e të rejat nga këto kriza, pedagogët janë duke zhvilluar metoda, teknika dhe programe krejt të reja. Nuk duhet harruar se në këto provime më të suksesshëm nuk

janë ata ose ato që kanë më shumë frikë e siklet nga provimet, jo ata ose ato që krijojnë tensione të brendshme në shpirtin e tyre, porse ata ose ato që i zhvillojnë njohuritë dhe intelektin e tyre praktik sipas përmasave të temave të provimit si dhe ata ose ato që pjekurinë e tyre psikologjike e zhvillojnë në drejtim të rekomandimeve të ekspertëve të kësaj fushe. Po kështu, gjatë kohës së provimeve vazhdimisht t'i bësh dua (lutje) Allahut, të kërlesh ndihmë nga Ai për t'i kaluar sa më lehtë e pa ngarkesa psikike të njëjtat, janë arsye shtesë për krijimin e një ambienti të qetë pune a studimi. Në këtë proces nuk duhet harruar as parimin e besimit islam të mbështetjes në Zot. Pra besimin se, nëse nuk arrihen disa synime edhe pas një angazhimi të nevojshëm për to, tjetrën duhet lënë në dorë të Zotit. Sepse në dukje të parë disa gjëra që duken të mira, në fakt mund të dalin sherr, e disa të tjera, edhe pse duken sherr, mund të dalin mirë. Rru-

ga më e logjikshme është që këtë situatë ta shtrijmë në kohë. Këtu, në rast të mossuksesit të të riut ose të resë, shumë me rëndësi është edhe mënyra e reagimit të familjes, të shkollës dhe të rrethit të miqve të tyre.

Nuk duhet të harrojmë se presioni, nënçmimi, përbuzja dhe mosvlerësimi i nevojshëm, ndonjëherë mund të shkaktojnë rënien në krizë të pakuptimtë dhe në shkëputjen nga jeta të njerëzve që i duam më së shumti. Në situata të këtilla të mossuksesit duhet vënë nën kontroll emocionet dhe nuk duhet lejuar që mendjen ta lodhin e konsumojnë mendimet negative, porse atë duhet angazhuar me mendime pozitive dhe duhet gjetur fusha fokusimi për arritjen e synimeve të tjera të mundshme. Një mendje e zënë peng në sukseset dhe/ose mossukseset e së kaluarës, është një element që njeriut vazhdimisht i vjedh shumëçka nga e ardhmja e tij. Njerëzit e fuqishëm e të suksesshëm

në jetë, bile edhe gjendjet më negative të së kaluarës së tyre, kanë arritur t'i tejkalojnë dhe t'i mundin duke i renditur thjesht si përvoja të përjetuara dhe duke ndërtuar mbi to diçka të re e pozitive. Prandaj, vullneti i fortë dhe i lirë duhet të jetë i aftë që për çdo herë të tejkalojë çdo situatë të pamueshme që e sjell me vete jeta. Kjo aftësi në fakt është e pranishme te çdo njeri që ka mendje të shëndoshë. Gjatë këtij procesi mbështetja në mëshirën dhe kujdesin e Zotit të Madh do të hapë dyer të reja të suksesit, mundësi të reja të mendjes si dhe pasurim të botës materiale e shpirtërore të njeriut.

4. Mekanizmat e komunikimit si një problem i të rinjve

Koha e komunikimit në të cilën jetojmë, në fakt është koha kur mjetet e lojës e të argëtimit e mbisundojnë jetën e të riut e të resë në veçanti. Me-

kanizmat e komunikimit në mendjen e njeriut mbjellin çdo lloj elementi të argëtimit, të lojës e të shprehive të ndryshme; në veçanti kinematë, muzika, radioja, lojërat kompjuterike, interneti dhe rrjetet sociale, herëherë lënë përshtypjen se jeta virtuale po e zëvendëson jetën reale të njeriut. Lojërat e ndryshme, heronjtë virtualë, ambientet virtuale alternative, fqinjët virtualë etj., në veçanti të rinjtë dhe të rejat i vënë përballë mendimeve, kuptimeve, ideve, doktrinave, vlerave, lëvizjeve e formave të jetës nga e mbarë bota.

Në të njëjtën mënyrë, edhe fantazitë virtuale që nuk mund të jetojnë dot në jetën reale, i shkëputin të rinjtë dhe të rejat nga jeta e vërtetë, ua topisin mendjen dhe pothuajse i bombardojnë me gjëra virtuale, të pavërteta e utopike. I shtypur nga këto presione, truri i njomë i të riut dhe i së resë e humbet origjinalitetin, aftësinë si dhe natyrshmërinë e tij; ai lëkundet

në mënyrë permanente midis botës reale dhe asaj virtuale. Më pas, një tru i shembur përtokë, duke e tharë dhe duke e shterur dinamizmin e të riut dhe të resë, ai e lë atë të paaftë dhe të pasuksesshëm për në jetën familjare, shkollore dhe shoqërore. Me këtë na shfaqet një prototip njeriu që jeton midis jetës dhe vdekjes dhe që priret drejt vetëvrasjes.



Është e arsyeshme dhe e kuptueshme që të rinjtë dhe të rejtat ta përdorin botën virtuale për të mësuar, për të

kërkuar urtësinë dhe për të luajtur me masë. Mirëpo përdorimi i saj përtej këtyre kufijve dhe angazhimi i plotë i jetës së të riut dhe të resë me këtë botë virtuale, shkakton turbullira në botën e njohurive të tyre si dhe e ndot mendjen e dëlirë të tyre. Kjo situatë prodhon rezultate negative për një të ri dhe të re që ndodhet në fazën e zgjedhjes së një profesioni dhe krijon pashmangshëm humbjen e kohës për të mësuar. Është vënë re se disa të rinj dhe të reja të moshës së adoleshencës, që lakmohen pas heronjve dhe heroinave virtuale, shpeshherë tregojnë prirje për rrëshqitje drejt mendimeve për vetëvrasje, madje edhe tentojnë të bëjnë vetëvrasje.

Të rinjtë, që jetën e vet e kalojnë nën dritën e mësimave hyjnore, pritet të jenë të vetëdijshëm për dëmet dhe të këqijat e botës virtuale dhe kohën e tyre, që është kapitali i tyre më i shtrenjtë, ta harxhojnë në gjëra të dobishme e me vlerë për ta.

5. Rrymat pesimiste, varësitë dhe të rinjtë

Rinia është mosha kur njeriu ia hap mendjen, veprimet dhe stilin e jetës së vet çdo lloj mendimi dhe kur ndikohet dukshëm nga këto mendime. Mediat, kinemaja, muzika etj., të gjitha këto ushtrojnë ndikim të dukshëm në botën e të riut dhe të resë. Lirisht mund të themi se sot të rinjtë dhe të rejat, nëpërmjet mjeteve të komunikimit ballafaqohen me kultura, mënyra jetese, moda, kulte nga më të ndryshmet si dhe me besëtytni moderne.

Një listë të gjatë të lëvizjeve filozofike me prirje pesimiste, sipas së cilave jeta në këtë botë është e keqe, se jeta e vërtetë fillon me vdekjen, se njeriu në këtë botë është i syrgjynosur, i përzënë, prandaj edhe për të arritur te jeta e vërtetë ai sa më parë duhet të heqë dorë nga kjo jetë trupore e mendime të ngjashme, e gjejmë që nga antika greke e deri në botën tonë moderne.

Këto ide, të cilat mund t'i quajmë si shkaktare filozofike të vetëvrasjes, bien ndesh me qëllimet e krijimit të njeriut si dhe me parimet dhe mësimet bazë të fesë islame. Mirëpo idetë e këtyre lëvizjeve fitojnë shtrirje të gjerë në sajë të marrjes së formave të ndryshme si dhe në sajë të funksionit të mjeteve të komunikimit masiv.

Disa të rinj të kohës sonë, me anë të stilit dhe rrymës së muzikës që e kanë përqafuar, mëtojnë ta riformatojnë mbarë stilin e jetës, madje edhe t'i ripërcaktojnë marrëdhëniet brenda familjes, shoqërisë dhe rrethit të miqve të tyre.

Po ashtu, rrugicat, vendet nën ura, metrotë, parqet e ndryshme si dhe oborret e shkollave po bëhen gjithnjë e më shumë vende tërheqëse ku të rinjtë përdorin llojet e ndryshme të drogës e të lëndëve të ndryshme narkotike, të cilat po e shkatërrojnë në masë të konsiderueshme jetën e tyre. Këto vende duken atraktive edhe nga

arsyeja se ato ndodhin në prag të jetës së tyre të njomë dhe se më parë nuk e kanë përjetuar një përvojë të tillë. Një pjesë e vetëvrasjeve në vendin tonë vjen edhe si pasojë e këtyre varësive dhe shprehive negative. Për shembull, një vajzë e re që studion mjekësinë, duke qenë e varur nga këto lëndë narkotike, mund të marrë dozë të tepruar të saj me çka shkakton (vetë)vrasjen. Është e njohur nga ana e ekspertëve se varësia ndaj këtyre lëndëve zhvillohet brenda një procesi të përshkallëzuar në organizmin e njeriut: nga më të lehtat drejt më të rëndave, më të fuqishmeve, e me këtë edhe drejt më shkatërrimtareve.

Të rinjtë duhet të rrinë larg këtyre varësive. Në qoftë se eventualisht i kanë provuar ato, menjëherë duhet të kërkojnë ndihmë mjekësore profesionale. Sepse më së shumti këtu vlen deviza: “Kurdo që t’ia kthesh shpinën së keqes, del fitimtar.” Përndryshe,

varësia nga lëndët narkotike mund të të çojë deri në vdekje. Po ashtu, për shkak të pasojave kronike që mund t'i sjellë me vete ky proces, ndodhin vuajtje të ndryshme dhe jo rrallë herë përfundojnë me vetëvrasje.

6. Bixhozi si një problem i të rinjve

Feja jonë e ka ndaluar çdo lloj të lojërave të bixhozit (kumarit). Edhe atë për shkak të shumë arsyeve dhe urtësive. Në fillim bixhozi shfaqet vetëm si një metodë e thjeshtë e fitimit të parave dhe në mendje krijon bazën për ngulitjen e një bindjeje pozitive ndaj tij. Ndërkaq me kalimin e kohës bixhozi ua gllabëron të rinjve paratë e xhepit, ua shuan oxhaqet familjare, ua shkatërron jetën e tyre profesionale dhe krijon varrë të pashërueshme në jetën mendore dhe materiale të tyre.

Një i ri i infektuar nga varësia e bixhozit nuk arrin ta kontrollojë në

mënyrë të shëndoshë botën e tij mendore, duke u përpëlitur vazhdimisht me presionin që sjell humbja e vazhdueshme në bixhoz, ai jo rrallë herë e çon mendjen edhe të vetëvrasja. Kjo edhe nga arsyeja se bixhozi për një kohë të shkurtër i gëlltit fitimet që ai i ka mbledhur me mund dhe djesë për vite të tëra.

Njeriu që luan bixhoz, në fillim është i sigurt qind për qind se do të fitojë. Mirëpo, pasi të ketë kaluar një kohë, duke qenë se tanimë e ka bërë pjesë të jetës së tij varësinë ndaj bixhozit, tek ai krijohet ndjenja dhe pasioni se ai do të fitojë gjithsesi në lojën e ardhshme. Njeriu me shpirt të infektuar nga varësia dhe pasioni i bixhozit, atë që mund ta ketë fituar një herë, do ta humbasë përsëri në bixhoz, duke menduar se do të fitojë më shumë ose se me anë të tij do t'i rikthejë ato që i ka humbur më parë.

Ndërkaq fakt është se sa më shumë që t'i jepesh kësaj rruge, zhytesh

gjithnjë e më shumë në humbje të paktëshme. Në fillim, të gjitha mjetet dhe lojërat e bixhozit mund t'i jenë dukur të arsyeshme, të logjikshme, të matura dhe si punë hobi a qejfi, me kalimin e kohës kjo punë i humbet këto veçori dhe ai zhytet gjithnjë e më thellë në baltën dhe kënetën e padalshme të kumarit. Fjala popullore: "Kush është bërë shtëpi a zengjin nga bixhozi?", e përshkruan më së miri psikologjinë e kësaj gjendjeje.

Një i ri i kapur nga pasioni i bixhozit duhet t'i drejtohet një eksperti për t'i ndihmuar të dalë nga aty dhe duhet t'i drejtohet edhe Zotit për falje të këtij mëkati të rëndë. Mendimi se "kam humbur shumë dhe se këtë mund ta rikthej vetëm nëpërmjet bixhozit", jo që nuk do t'i ndihmojë atij në këtë drejtim, por do ta zhytë atë në humbje akoma më të thella.

7. Prostitucioni dhe të rinjtë

Prostitucioni dhe bashkë me këtë edhe lidhjet e shtrembëta, jo legjitime, përbëjnë një temë shumë me rëndësi kur janë në pyetje problemet e të rinjve. Një i ri që njihet si “*mukelef*” (i përgjegjshëm), duke qenë i mençur dhe i pjekur, pritet që për udhëzues të jetës së tij ta ketë madhështinë e etikës islame. Kryerja vetëm e njëhershme madje e këtyre mëkateve mund të bëhet shkak për rënien në pozitë të keqe të njeriut si në sytë e familjes, ashtu edhe në atë të shkollës e shoqërisë. I riu dhe e reja muslimane, duke qenë se ndodhet në një fazë kritike të jetës së vet, duhet ta ruajë nderin dhe pastërtinë e vet morale e njerëzore, duhet t’ia vërë veshin thirrjes kur’anore për të mos iu afruar zinasë, marrëdhënieve intime jashtë martesore dhe aq më pak prostitucionit. Ai duhet t’i ndjekë edhe mësimet e rekomandimet e pejgamberit Muhammed a.s. për këtë si-

tuatë, kur ai porosit ndër të tjera edhe agjërimin *nafile* të kohëpaskohshëm.

Në qoftë se një i ri ose një e re eventualisht ka hyrë në këta ujëra të mëkatit të zinasë duke u mashtruar nga *nefsi* (epshi) dhe nga cytjet e shejtanit, duhet që sa më parë t'i drejtohet Zotit dhe të kërkojë falje dhe pastrim nga Ai për këtë.

8. Rinia dhe dashuria e pashpresë

Të dashurohesh është njëra prej dukurive më të zakonshme që haset te të rinjtë dhe të rejat. Hulumtuesit shkencorë kanë gjetur se disa të rinj e të reja këtë gjendje njerëzore e kalojnë në mënyrë shumë intensive, ndërkaq disa të tjerë në mënyrë shumë të sipërfaqshme. Gjatë historisë gjithmonë ka pasur raste kur një i ri ose një e re ia merr vetes jetën vetëm pse nuk merr përgjigje për dashurinë

që e ka në shpirt për gjininë e kundërt.

Një prej vetive të All-llahut xh.sh. është edhe bukuria, pra Ai është i Bukur. Sipas botëkuptimit mistik të Islamit All-llahu xh.sh. është burimi i çdo një bukurie në sipërfaqen e tokës.

Në disa situata koha është shërimi apo ilaçi i çdo gjëje. Ata që bëjnë vetë-vrasje për shkak të dashurisë, sikur ta kishin vonuar këtë akt edhe për një 3-4 vjet më tej, do ta kishin kuptuar dhe pranuar edhe vetë se sa sjellje absurde dhe e palogjikshme që është kjo. Ata që në njëfarë forme ndiejnë dashuri të fortë ndaj gjinisë tjetër, do të ishte mirë të lexonin dhe të merreshin me poezitë e poetëve të mëdhenj muslimanë, si Mevlana Xhelaluddin Rumi, Junus Emre, Shejh Galibi etj., të cilët kanë shkruar vargjet më të bukura për dashurinë, në mënyrë që të krijojnë një qetësi shpirtërore dhe që të mund të dalin nga dashuria njerëzore drejt pangopshmërisë së da-

shurisë hyjnore. Kur Rumi thotë se një dashuri mund të largohet vetëm me një dashuri tjetër, ka për qëllim mundësitë e shumta që i ofron jeta, në veçanti kur është në pyetje ngritja shpirtërore.



IV. Problemet e të rinjve dhe parimet islame në lidhje me vetëvrasjen

1. Problemet e të rinjve dhe besimi në Zot

Feja islame besimin në Zot e konsideron si bazën më të rëndësishme të besimit. All-llahu xh.sh. në Kur'an e ka ndaluar vetëvrasjen me paramendim. All-llahu xh.sh. është Ai që di, sheh dhe dëgjon çdo gjë. Drejtësia e Zotit kaplon çdo fushë të jetës në këtë botë. Gjërat që në këtë botë realizohen si padrejtësi, në fakt janë vetëm rrjedhojë e sprovës së njerëzimit. All-llahu xh. sh. deri në njëfarë kohe njerëzit i ka lënë të lirë midis shumë alternativash, prandaj edhe pikërisht për këtë edhe i ka bërë përgjegjës për veprat e tyre. All-llahu Fuqiptotë me mëshirën dhe dhembshurinë e Tij është gjithmonë pranë njeriut në rastet më të vështira të tij. Ai është më afër njeriut sesa edhe damari i qafës së tij. Ai në Kur'an thotë: *"E kur*

robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua.” (el-Bekara, 2:186). Po ashtu, Ai në një hadith kudsij thotë: *“Kush më afrohet Mua sa një pëllëmbë, Unë i afrohem atij sa një krah (kut), kush më afrohet Mua sa një krah, Unë i afrohem Atij sa një pash, e kush vjen drejt Meje duke ecur, Unë shkoj drejt tij duke ngarendur.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Prandaj, një i ri ose e re që beson në Zot, edhe sikur të ketë rënë në ndonjërin prej problemeve të të rinjve që i përmendëm më parë, ai duhet t'i kthehet Zotit, të strehohet tek Ai, të kërkojë falje prej Tij dhe t'i mbështetet plotësisht Atij.

Jeta e kësaj bote, sipas Kur'anit, është një lojë dhe dëfrim, por në të njëjtën kohë edhe vend sprove për njeriun. Dhe njeriu, siç sprovohet me mëkatet e tjera, në të njëjtën mënyrë sprovo-


het edhe me mendimin dhe veprimin e vetëvrasjes. Mirëpo, përderisa të mëkatet e tjera ekziston mundësia që në një farë forme të kërkohet falje dhe të shprehet pendimi (*tevbeja*), mbas realizimit të vetëvrasjes njeriu nuk ka më mundësi t'i hapë duart drejt Zotit dhe të kërkojë falje. Për këtë arsye, njeriu që mendon të bëjë vetëvrasje, nuk duhet të harrojë se ky mëkat nuk është sikurse mëkatet e tjera. Përkundrazi, ai duhet ta dijë se përderisa ai vazhdon të jetojë, gjithnjë do të ekzistojë mundësia që All-llahu t'ia hapë atij dyert e furnizimit (*rizkut*), të hapjes së mendjes, të fitimit të të mirave e të lumturisë në këtë dhe në botën tjetër.

Nuk duhet harruar faktin se për njeriun, që është krijesa në pozitën më dramatike në këtë botë, All-llahu xh. sh. është më afër tij sesa damari i qafës (arteria) që ai e ka (Kur'ani, 50:16).

Po kështu, All-llahu xh.sh. nuk e ka ngarkuar njeriun në këtë botë me ngarkesa e me përgjegjësi, të cilat ai s'mund t'i bartë (Kur'ani, 2:286). Për këtë arsye, i riu dhe e reja duhet të pranojnë se ngjarjet e rënda dhe dramatike njerëzore që u bien mbi kokë ndodhin me caktimin e Zotit; se për zgjidhjen e këtyre problemeve ata fillimisht duhet t'u drejtohen njerëzve kompetentë, që do të mund t'i kuptonin ata dhe problemet e tyre; dhe se duhet ta mbajnë në mend gjithmonë se ata pranë vetes e kanë Zotin, se janë përgjegjës para Tij dhe se mëshira e Tij kaplon gjithçka. All-llahu i Plotmëshirshëm është afër njeriut madje edhe në momentin kur ai është më i zemëruar, më rebelues, më pesimist dhe më i pashpresë.

"Një i ri ose një e re përjeton kohëra tejet të tensionuara me mendimin se 'nëse nuk e kaloj provimin pranues do të më shkatërrohet e ardhmja ime, kush e di se çfarë do të thotë pastaj familja

ime, shokët e miqtë e mi'; një tjetër i ri ose e re përvëlohet natë e ditë pse personin që e dashuronte aq shumë ka zgjedhur të fejohej e të martohet me dikë tjetër; një i ri ose e re tjetër ëndërron me mall botën e vet utopike që e



ka krijuar në kokë, duke e mallkuar sistemin ekzistues, i cili, sipas tij ose saj, është shumë larg nga bota e vet dhe se atij ose asaj nuk ia njeh të drejtën e jetesës në një botë më të mirë; një

tjetër e ha veten vazhdimisht, sepse ka frikë se do t'i dalë në shesh e keqja dhe mëkati, të cilin e kishte bërë, dhe mendohet thellë se si do të reagojë familja dhe shoqëria kur ta marrë vesh këtë; një i ri ose një e re tjetër përballët me të gjitha institucionet tradicionale nga arsyeja se e ndien veten të tërhequr nga mendimet e rrymës terse që e ka përqaftuar; një i ri ose një e re tjetër mbyllet dhe izolohet në dhomën e vet duke menduar se i është vjedhur e tërë lumturia, vetëm nga arsyeja se babai ose nëna e kanë kundërshtuar në plotësimin e ndonjë dëshire; një tjetër i ri përpëlitet ngase të gjitha paratë që i kishte pasur i kishte harxhuar në bixhoz; një i ri ose një e re tjetër e ndien jetën tejet të ngushtuar duke menduar se ku do ta çojë shiringa që e kishte ngulur në damarët e vet duke marrë lëndë narkotike; një tjetër po lufton me sikletin e papunësisë edhe pse kanë kaluar vite qëkur i ka kryer studimet; një tjetër, duke i parë mundësitë materiale dhe luksin që po e përjetojnë mo-

shatarët e tij ose të saj, mbytet në zemërimin dhe zhgënjimin që lind nga varfëria dhe nga e ardhmja e tij ose e saj e errët që po e përfytyron në kokën e vet..."

Të rinjtë dhe të rejat që i përjetojnë të gjitha këto situata të mësipërme duhet ta dinë se Ai që problemet e tyre i di më së miri dhe që është i pari dhe i fundit që mund t'u ndihmojë në zgjidhjen e tyre është All-llahu Fuqiplotë. Një njeri që përpëlitet me problemet dhe sikletet e rinisë, duhet t'i drejtohet Zotit për shpresë dhe të kërkojë prej Tij faljen e mëkateve eventuale si dhe të largohet sa më parë nga ato mëkate duke e ditur se për mundësi të reja në jetë Zotin e ka ndihmës më të afërt sesa edhe vetë damarin e tij të qafës dhe i Cili di, sheh dhe dëgjon absolutisht gjithçka.

Si përfundim, All-llahu është Zotëriu dhe Ndhimësi final i çdo një të riu ose të reje që ka rënë në vorbullën e problemeve të jetës.

2. Problemet e të rinjve dhe besimi në Ahiret

Gjatë gjithë historisë, por edhe sot e nesër, do të ndodhin padrejtësi e diskriminime të formave të ndryshme që lindin nga vetë njerëzit dhe të cilat i kaplojnë të gjitha njësitë sociale, nga më e vogla familja e deri te ato më të mëdhatë, shoqëritë dhe mbarë njerëzia.

Feja jonë islame na bën qartë me dije se të mirën sado të vogël që e bën dikush, shpërblimin për të do ta marrë në botën tjetër, porse edhe për të keqen më të vogël, dënimin do ta marrë po ashtu, se kjo botë është ara e ahiretit dhe se çfarëdo që të mbjellim në këtë botë, do ta korrim në botën tjetër.

I riu dhe e reja që janë dëshmitarë të të gjitha këtyre veprimeve, nuk duhet ta harrojnë faktin se ata që ushtrojnë padrejtësi, diskriminim dhe çfarëdo një sjellje tjetër të keqe, për të gjitha

këto do të japin llogari përpara All-llahut xh.sh. dhe se do ta marrin dënimin e merituar. All-llahu xh.sh. shumë qartë na ka bërë me dije në Kur'an se Ai në Ahiret do ta vendosë peshoren e veprave të njerëzve dhe se Vetë do të kujdeset të marrë hak kundrejt atyre që kanë bërë padrejtësi e çrregullime në tokë.

Një i ri ose një e re që mund të jetë ngatërruar në sjelljet negative të lartpërmendura, nuk duhet të largohet nga rruga e drejtë që ia ka treguar All-llahu xh.sh. dhe nuk duhet të harrojë se që nga mosha e pubertetit ai ose ajo është e lirë të veprojë në këtë botë sipas vullnetit të vet personal, por edhe se në botën tjetër do të japë llogari përpara All-llahut xh.sh. për veprimet e veta. Këto padrejtësi që i bëhen atij ose asaj, duhet t'ia lërë në dorë Zotit. Për më tepër, nëse njeriu në këtë botë e kalon një jetë të mirë, edhe në ahiret do të mund të jetë i lumtur. Për këtë arsye, dhimbjen që e

përjeton i riu ose e reja me rënien nga një provim a test, varfëria, papunësia etj., të gjitha këto janë gjendje të kalueshme të kësaj bote. Për hir të lumturisë së ahiretit njeriu duhet t'u bëjë ballë disa brengave të kësaj bote, edhe pse ai angazhohet mjaftueshëm që këto të mos vijnë, megjithëkëtë ai duhet ta vazhdojë luftën e tij për jetë deri në fund duke u mbështetur në mundësitë e tjera të shumta që i ka caktuar dhe hapur Krijuesi i gjithësisë, All-llahu xh.sh.. Të bësh vetëvrasje në fakt nënkupton të heqësh dorë nga mundësia, mëshira dhe furnizimi i ardhshëm. Sipas Kur'anit, më me rëndësi nuk janë lumturitë e përkohshme të kësaj bote – edhe pse edhe këto janë të nevojshme -, porse lumturia e amshueshme dhe e pashtershme e ahiretit e arritur me fitimin e provimit të kësaj bote. Të bësh vetëvrasje në moshën e rinisë në fakt do të thotë të ikësh dhe t'ua kthesh shpinën të gjitha mundësive të kësaj lumturie dhe këtij shpëtimi personal.

3. Problemet e të rinjve dhe *teubeja* (pendimi)

Teubeja nënkupton pendimin për kryerjen e ndonjë mëkati (gjynahu) si dhe zotimin para Zotit se nuk do të kthehesh më edhe një herë tek ai mëkat. Kur janë në pyetje kushtet e pranimit të *teubes*, dijetarët islamë kanë përcaktuar disa kritere, mirëpo si më të rëndësishmin e kanë konsideruar sinqeritetin dhe vendosmërinë e paluhatshme me rastin e pendimit. Në fenë tonë islame nuk ka asnjë fuqi a autoritet që ndodhet midis Zotit dhe njeriut dhe se për çdo lutje a pendim nuk njihet mundësia e asnjë farë mjeti të këtillë.

Në disa situata *teubeja* ka mundësi ta parandalojë dukurinë e vetëvrasjes, e cila burimin e ka te dhimbjet, vuajtjet dhe problemet e të rinjve. Kjo nga arsyeja se ekzistojnë bindje të gabuara në mesin e të rinjve kinse mëkatet e bëra një herë mbeten të tilla, të pandreqshme e të pafalura përgjithmo-

në. All-llahu xh.sh. dyert e pendimit dhe të faljes i ka hapur krah më krah dhe Ai në Kur'anin fisnik thekson se për çdo vepër të keqe pason dënimi për të dhe menjëherë pas kësaj Ai na bën me dije qartë se megjithëkëtë nuk ka asnjë mëkat të cilin Ai nuk e fal dot. (Shikoni për më tepër në suret en-Nisa', 4:17; el-En'am, 6:54; ez-Zumer, 39:53; et-Tahrim, 66:8.)

Të rinjtë dhe të rejat nuk duhet të infektohen me mëkatet që në fenë tonë njihen dhe konsiderohen si të mëdha, siç janë: alkooli, bixhozi, zinaja, lëndët narkotike e të ngjashme. Në qoftë se eventualisht janë futur në to, nga pahiri ose të mashtruar nga shejtani, ata duhet sa më shpejtë që të jetë e mundur të pendohen para Zotit dhe të kërkojnë falje, strehim dhe mbrojtje përsëri tek Ai. Përndryshe ata nuk do të mund të largohen e të shpëtojnë prej këtyre mëkateve sa të jenë gjallë.

Ka momente kur njeriu hamend se për mëkatin e bërë ai nuk do të falet

asnjëherë dhe pikërisht për këtë edhe jo rrallë herë ai ftohet nga feja e nga fetaria, i braktis sjelljet dhe veprat e mira që mund t'i ketë bërë më herët dhe në fund sjell ndër mend edhe vetëvrasjen.



Mirëpo, sipas fesë sonë islame, ky mendim a hamendje është gabim. Nga arsyeja se çfarëdo mëkati dhe sado mëkat të madh që të ketë bërë njeriu, dera e *teubes*, e pendimit, e korrigjimit dhe e ndreqjes mbetet e hapur.

Le të theksojmë për fund edhe faktin se të vazhdosh të bësh mëkat duke pohuar se "do të pendohem më vonë, kam kohë", është një qëndrim i gabuar i njeriut në raport me Zotin.

4. Problemet e të rinjve dhe *tevekkuli* (mbështetja në Zot)

Tevekkul do të thotë të ndërmarrësh gjithçka për ta arritur një sukses a për ta kryer një punë dhe në fund rezultatin ta presësh nga Zoti.

Në kontekst të problemeve të të rinjve *tevekkuli* luan një rol pengues kur janë në pyetje shumë shqetësime e brenga të moshës së rinisë. Ashtu siç e kemi përmendur tanimë, periudha e rinisë është momenti kur të rinjtë ndiejnë brenga e derte në disa çështje dhe këto brenga brenda vetvetes mund të çojnë në sjellje negative madje edhe deri në vetëvrasje. Për shembull, një i ri ose një e re mund ta ketë problem dhe gajle zgjedhjen e

një profesioni ose se për këtë ai ose ajo duhet të hyjë në provim pranues e të ngjashme. Për këtë provim pranues ndoshta nevojitet përgatitje disa mujore. Këtu me rëndësi është që i riu ose e reja paralelisht një metode të përshtatshme, ai ose ajo duhet të ndjekë edhe një program të arsyeshëm pune. Mirëpo, në qoftë se gjatë këtij procesi njeriu e shpërfill dhe nuk e zbaton si duhet programin e nevojshëm për punë dhe fillon ta ushqejë vetveten me gajle e brenga si "Çka do të bëhet me të ardhmen time?", "Çka do të ndodhë nëse unë nuk e kaloj këtë provim?", "Çka do të thonë prindërit dhe shokët e shoqet e mia për këtë?" e të ngjashme, atëherë kjo do ta fusë atë në një krizë të thellë dhe do t'ia rrënojë tërësisht mënyrën e punës së programuar. Prandaj, këtu është shumë me rëndësi që sa më shumë që të jetë e mundur ai ose ajo të fokusohet e të përqendrohet në synimin dhe cakun e vet, ashtu siç e rekomandojnë këtë edhe ekspertët e

kësaj fushe, dhe të mos u japë shkas gajleve e dertëve të pavend që mund të nguliten në shpirtin e tij ose të saj.

Një i ri dhe një e re e pajisur me virtytin e *tevekkulit*, në situata të këti-lla e përcakton programin e vet të punës, i zbaton metodat e përshtatshme dhe pa e harruar cakun ose synimin kryesor vazhdon të punojë e të angazhohet dhe në fund të krejt kësaj rezultatin e lë në dorë të Zotit. Ka të ngjarë që ndonjëherë edhe pse njeriu i përzgjedh metodat më të përshtatshme, i zbaton programet më të disiplinuar, ai përsëri nuk arrin ta realizojë synimin a qëllimin e tij. Një njeri që mbështetet në Zot, në një rast të këtillë ka mundësi të thotë: “Unë bëra gjithçka që munda, i provova mëto- dat më të mira, e vazhdova angazhimin tim në mënyrë të disiplinuar, pra i ndërmora të gjitha masat dhe në fund çështjen time ia lash në dorë Zotit, do me thënë Zoti paska caktuar që rezultati im të jetë ky që është.”



Tevekkuli (mbështetja në Zot pas punës) ia mundëson njeriut që të përqendrohet në synime të reja, në mundësi dhe shanse të reja si dhe ia mundëson që të kapet pas mjeteve më të arsyeshme e më racionale të jetës dhe të vazhdojë tutje pa i shkëputur lidhjet e tij me Zotin.

5. Problemet e të rinjve dhe durimi

Në fillim, për shumë të rinj e të reja, durimi (*sabrî*) nuk merret seriozisht dhe madje konsiderohet si diçka e neveritshme. Mirëpo, kur të rinjtë ta arrijnë një sukses duke u bërë ballë sfidave, pra duke duruar e bërë sabër, duke qenë rezistues dhe këmbëngulës, do ta kuptojë se sa me vlerë është virtyti i durimit në luftën për jetë.

Në fakt durimi (*sabrî*) është ilaçi i pashmangshëm për shumë probleme e derte që bartin në vete potencial për vetëvrasje.

Sabri assesi nuk nënkupton dorëzim dhe dembelizëm dhe aq më pak nuk nënkupton legjitimimin a përligjjen e padrejtësive dhe të diskriminimeve.

Durimi është një fuqi e brendshme qetësuese dhe mbështetëse, e cila me ndihmën e Zotit njeriut ia mundëson t'u bëjë ballë dhe rezistencë sikleteve

dhe vështirësive të jetës, ia dhuron atij qëndrueshmërinë e nevojshme si dhe potencialin që gjërat negative t'i kthejë në pozitive. Sipas kësaj, durimi (*sabrî*) nuk është një element që e ftoh njeriun nga jeta, por përkundrazi



është një parim që e lidh atë akoma më ngushtë me jetën. Në të njëjtën kohë, durimi është edhe dhënie afat vetvetes në rrugën për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Kur'ani fisnik kur flet për pejgamberin Ejub a.s., e përmend atë si një simbol të durimit të pashembullt njerëzor. Pejgamberi Ejub a.s. i duroi, me ndihmën e Zotit, dhimbjet e rënda që e kapluan atë dhe më në fund Zoti ia dha shpërblimin për këtë durim.

Përfundim

Secila fazë e jetës i ka veçoritë, problemet, sikletet por edhe bukuritë e saj. Feja jonë islame i ka parimet dhe mësimet për zbukurimin e secilës periudhë të jetës sonë. Edhe periudha e rinisë i ka veçoritë dhe problemet e saj të veçanta. Një i ri dhe një e re muslimane, në çdo fazë të rinisë së vet, duhet ta marrë shembull dhe model jetën dhe moralin e Muhammedit a.s.

Besimi islam në Zot, në ahiret dhe në *kader*, si dhe parimet e *tevekkulit* e të *teubes*, bashkë me virtytin e sabrit, ia mundësojnë njeriut që t'u bëjë ballë vështirësive të jetës, e në veçanti e pengojnë të riun dhe të renë nga mendimet që mund ta çojnë atë në vetëvrasje, si dhe ia hap atij ose asaj dyert e bukurive të mundshme të kësaj bote dhe mundësinë e lumturisë së amshueshme të ahiretit.

Sipas fesë islame All-llahu xh.sh. është Ai që na ka dhënë amanet jetën dhe ekzistencën tonë. Por edhe trupi ynë është një amanet që na ka besuar Zoti. Andaj edhe e kemi obligim që ta ruajmë këtë trup deri sa na ka caktuar jetën Zoti.

Në Kur'an All-llahu xh.sh. e ka ndaluar vetëvrasjen me paramendim. Dije-tarët islamë kanë pohuar se është çështje midis Zotit dhe njeriut nëse njeriu që bën vetëvrasje konsiderohet besimtar ose mohues, pikërisht për këtë edhe kanë thënë se atij personi i falet namazi i xhenazes dhe i njëjti varroset në varrezat e muslimanëve.

Shënime:

